



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.80/22

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, me gjyqtaren Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit ....”me numër te biznesit .... me seli ne lagjen .... ne Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve ‘SCLR Partners”, sh.p.k me seli në Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, ndaj debitorit ”Ministria e Shendetësisë” rr.Zagrebit nr.60 me seli ne Prishtinë, përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm Civil PPP.nr.139/19, të datës 15.08.2019, me datë 06.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit ”Ministria e Shendetësisë” rr.Zagrebit nr.60 Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm Civil PPP.nr.139/19, të datës 15.08.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm Civil, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.139/19, të datës 15.08.2019, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar propësimin e debitorit Ministria e Shendetësisë, te ushtruar kundër urdhrin për përmbartim P.nr.1446/18 të datës 27.12.2018, te lejuar nga përmbartuesi privat Fadil Hoxha ne Pishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale te dispozitave te procedures kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkalles se dytë, ta aprovoj si të bazuar ankesën e debitorit, te prish aktvendimin e ankimuar ose ta ndryshoj apo çështjën ta thej ne rigjykim ndersa urdhrin për përmbartim ta anuloj.

Ndaj ankesës se debitorit përgjigje ka parashtruar kreditori “....”, me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori ne ankesën e tij ndërsa ka propozuar qe ankesa e debitorit te refuzohet ne tërësi si e pabazuar dhe aktvendimi i gjykares se shkalles se parë te vërtetohet.

Dhoma e Shkalles e Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturë me nr. .... të datës 31.12.2015. Përmbareuesi privat Fadil Hoxha nga Prishtina sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbaremore P.nr1446/18 të datës 27.12.2018, ka lejuar përmbaremoren, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën prej 23,000.00 euro, me kamatë prej 8% nga data e ushtrimit të këtij propozimi, deri në pagesën definitive të borxhit.

Kundër urdhrin përmbaremore debitori ka ushtruar prapësim me datën 10.01.2019, ndërsa gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.139/19 të datës 15.08.2019, ka vendosë që ta refuzoj prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin përmbaremore P.nr.1446/18 të datës 27.12.2018.

Ne arsyetim të aktvendimit Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar faturën me numër 01/31122015 të datës 31.12.2015 si dokument të besueshëm dhe bazë juridike për caktimin e përmbaremoren ngase e njëjta i ka plotësuar kushtet nga neni 21 dhe 29 i LPP dhe është e përshtatshme për përmbaremoren, ndërsa pretendimet e debitorit sa i përket parashkrimit të kërkesës së shpërblimit i vlerëson si të pabazuar, duke arsyetuar faktin se nuk kemi të bëjmë me parashkrim sepse fatura si dokument i besueshëm në këtë rast është e datës 31.12.2015 ndërsa propozimi për përmbaremore – urdhri përmbaremore është lëshuar me datën 27.12.2018 dhe si datë e parashkrimit do të ishte data 31.12.2018, andaj edhe nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës. Po ashtu gjykata e shkallës i vlerëson si të pabazuar edhe pretendimet e debitorit se nuk ka përfunduar procedura administrative sepse para nxjerrjes së fatures ka përfunduar procedura administrative. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë i referohet edhe nenit 69 par.4 të LPP të cilin debitori me rastin e paraqitjes së prapësimin nuk e ka respektuar.

Dhoma e Shkalles e Dytë e Gjykates Komerciale nisur nga kjo gjendje vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykates së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182 par.2 pikat., b), g), j), k) dhe m) të LPK dhe nuk ka zbatim të gabuar dhe jo të potë të gjendjes faktike ndërsa ka zbatuar drejt dispozitat materiale për çka edhe Doma e Shkalles së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se vendimi i shkallës së parë është bazuar në dokument të besueshëm, të paraparë me nenin 29 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore nr.04/L-139, ku

përcakton se “përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm, me tutje ky nen parasheh se “dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”, e që në rastin konkret dokumenti i besueshëm është edhe fatura nr. .... e datës 31.12.2015 për shumën e detyrimit prej 23,000.00 euro. Andaj pretendimet ankimore të debitorit sa i përket ekzistimit të parashkrimit dhe veprimeve administrative të kreditorit duke aluduar se janë kryer para ekzekutimit të pagesës si në faturë, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë, dhe se edhe kjo gjykatë vlerëson qëndrimin juridik të gjyqtes se shkallës së parë sepse e njëjta në bazë të dokumentacionit dhe shkresave në lëndë drejtë ka arsyetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt të drejtën materiale. Në këtë drejtim Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Në këtë drejtim pretendimet ankimore të debitorit u refuzuan si të pabazuara ndërsa aktvendimi i atakuar vërtetohet.

Në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Gjyqtes Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqatri individual.

Nga sa u tha më lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË  
DHOMA E SHKALLES SE DYTË  
K.DH.SH.II nr.80/22, me datë 06.10.2022

Gjyqtarja  
Sarada Bogaj-Sheremeti